



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.75/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti kryesues, Kujtim Pasuli dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 22.01.2025, merr këtë:

V E N D I M

- I. Pranohet e bazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, Anr.75/2025 e datës 20.01.2025.
- II. Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 1.500.00, (njëmijë e pesëqind) Euro.
- III. Detyrohet Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, që gjorbën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 20.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë me të cilën pretendon se me datë 19.01.2025 subjekti politik i LVV me rastin e shpërndarjes së disa njoftimeve për një tubim në Prishtinë ka shkelur nenin 34 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të LZP, i cili shprehimisht thotë: *vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve*", si dhe nenit 7 paragrafi 2, nën paragrafi 2.4, 2.6 dhe 2.11 të Rregullores zgjedhore nr. 07/2024.

Më tutje parashtruesi i ankesës thekson se duke u bazuar ne gjithë këto kërkojmë nga ana juaj si organ kompetent dhe i autorizuar që të shqiptoni masë sanksionuese ndaj subjektit politik LVV.

Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur katër fotografi që dëshmojnë vendosjen e posterëve - njoftimeve në kundërshtim me rregullativën zgjedhore.

Më datë 21.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri më 22.01.2025 në ora 09:00.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 22.01.2025, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ka kundërshtuar ankesën e paraqitur nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës lidhur me pretendimet e theksuara në ankesë dhe lidhur me rastin në fjalë, theksohet se vlerësojmë se vendosja e këtyre njoftimeve në vendet e pa lejuara është bërë pikërisht nga LDK dhe është fotografuar nga po ajo qëllimin e dëmtimit financiar të LVV-së. Nga provat e bashkëngjitura nga pretenduesi, nuk vërehet, ofrohet asnjë provë që dëshmon se LVV ose aktivistë të saj kanë vendosur ato njoftime në vende të pa lejuara. Më tutje në përgjigje në ankesë theksohet se meqë pretenduesi ka dështuar të provojë shkeljen e pretenduar në mënyre faktike dhe ta mbështesë atë me prova konkrete dhe për shkak të fabrikimit të këtij rasti nga vet LDK, kërkojnë nga PZAP që këtë ankesë ta refuzojë dhe ta hudhë poshtë si të papabuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se :

-Ankesa është e bazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga subjekti politik LVV, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik LDK, janë të qëndrueshme dhe si të tilla i aprovoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë paraqesin shkelje nga ana e subjektit politik LVV gjegjësisht e njëjta ka vendosur posterët në shtyllë dhe në trafo elektrike me të cilën u bënë thirrje qytetarëve për mbajtjen e tubimit zgjedhor me datën 19.01.2025 në ora 19:00 në shkollën Emin Duraku në Prishtinë ku do të merrnin pjesë kandidatët për deputet nga ky subjekt politik, ku me këto veprime ka shkelur dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se *“Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose ne hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.”*

Paneli shqyrtoi edhe përgjigjen në ankesë të subjektit politik LVV në të cilën e kundërshton ankesën e parashtruesit dhe ku thekson se posterat janë vendosur nga LDK dhe janë fotografuar nga po ajo, me qëllimin e dëmtimit financiar të LVV-së, për Panelin këto pretendime ishin supozime dhe nuk ishin të argumentuara në fakte dhe në prova konkrete.

Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes, dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se ky veprim i tyre përbën përsëritje të shkeljes së legjisllacionit zgjedhor, pra ka bërë shkelje të tilla edhe në proceset e mëparshme

zgjedhore dhe në këto zgjedhje. Kjo konsiston në faktin se Subjekti Politik LVV, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës zgjedhore. Andaj vendosja e posterëve-njoftimeve të subjektit të tyre politik për fushatë zgjedhore në objekte publike gjegjësisht në shtyllë dhe në trafo të energjisë elektrike në Prishtinë, përbën shkelje të legjislacionit zgjedhor, dhe të njëjta shkelje janë sanksionuar me dispozitat ligjore të LZP-së.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të qëndrueshme dhe si të tilla i pranoi, sepse kjo shkelje ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e pranoi si të bazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nen parafi 1.3 të LZP-së, të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.75/2025 datë 22.01.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së.